



REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
MINISTRIA E PUNËS DHE  
POLITIKËS SOCIALE

## STRATEGJIA PËR APLIKIMIN E

# BUXHETIMIT TË PËRGJEGJSHËM GJINOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (2012-2017)





Oваа публикација е изработена во рамки на регионалниот проект "Промовирање на родово одговорни политики во Југоисточна Европа,, (2011-2013) на Телото на Обединетите нации за Родова рамноправност и Зајакнување на жените (UN Women). Проектот е финансиски поддржан од UN Women и Австриската Развојна Соработка (ADC). Ставовите и мислењата изразени во оваа публикација се на авторите и нужно не ги одразуваат официјалните позиции на ADC, UN Women, Обединетите нации или некоја од придружните организации.

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit rajonal "Promovimi i Politikave të Përgjegjshme Gjinore në Evropën Juglindore" (2011-2013), të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women). Projektet është mbështetur financiarisht nga UN Women dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC). Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Agjencisë Austriake për Zhvillim, UN Women, Kombeve të Bashkuara ose të organizatave të bashkangjitura me të.

This publication was produced in the framework of the regional project "Promoting Gender Responsive Policies in South East Europe" (2011-2013) of the United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women (UN Women), financially supported by UN Women and the Austrian Development Cooperation (ADC). The views and opinions contained in the publication are those of the authors and do not necessarily represent the views of ADC, UN Women, the United Nations or any of its affiliated organizations.

# PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave

Rezyme

1. Hyrje

1.1. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor si vegël për përfshirjen e perspektivës gjinore në ngjarjet kryesore në shoqëri

1.2. Terminologjia dhe termet e përgjithshme

1.3. Metodologjia dhe qasja në përpilimin e Strategjisë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

1.4. Synimi kryesor i Strategjisë

2. Konteksti

2.1. Pasqyrim i përgjithshëm i gjendjes – domosdoshmëria për ndërlidhje e procesit të buxhetimit dhe barazisë gjinore

2.2. Korniza juridike, institucionale dhe procedimi i buxhetimit dhe planifikimit strategjik

2.2.1. Barazia gjinore

2.2.2. Korniza institucionale dhe kompetencat e subjekteve përgjegjëse lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

2.2.3. Procesi i buxhetimit dhe planifikimi strategjik

3. Strategjia për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

4. Mekanizmat për zbatim, vëzhgim dhe vlerësim

Shtojca 1. Bibliografia

Shtojca 2. Grupi i punës dhe ekspertët e përfshirë

## **Lista e shkurtesave**

QRM – Qeveria e Republikës së Maqedonisë

ESHR – Enti shtetëror për revizion

NJVL – Njësitë e vetëqeverisjes lokale

BE - Bashkimi Evropian

LMBGB – Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave

KETGJFDG – Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

MPPS – Ministria e punës dhe politikës Sociale

MF – Ministria e financave

SNBGJ – Strategjia nacionale për barazi gjinore

OASH – Organ i administratës shtetërore

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

RM – Republika e Maqedonisë

BPGJ – Buxhetim i përgjegjshëm gjinor

SMB – Sektori për mundësi të barabarta

SBNGJ – Strategjia për buxhetim të ndërgjegjshëm gjinor

## Rezyme

Republika e Maqedonisë është shtet demokratik dhe social në të cilën të gjithë janë të barabartë para ligjit, kurse një nga vlerat themelore është respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e saj.

Në Republikën e Maqedonisë ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për barazinë gjinore, e cila përfshin edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Në nenin 5 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave, theksohet se një nga masat themelore për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, janë edhe masat me anë të të cilave vendoset përfshirja sistematike e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në procesin e krijimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe buxhetet në zona të caktuara sociale, duke përfshirë edhe kryerjen e funksioneve dhe kompetencave të subjekteve nga sektori publik dhe privat. Megjithatë, hulumtimet dhe analizat<sup>1</sup> tregojnë se politikat shpesh ende kanë neutralitet gjinor dhe nuk i marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe burrave.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një mjet relativisht i ri për përfshirjen e perspektivës gjinore në ngjarjet kryesore. BPGJ mundëson që gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave të

---

<sup>1</sup> Shembull për praktikë të mirë në Republikën e Maqedonisë është hulumtimi: Analiza buxhetore-gjinore e mbrojtjes sociale dhe politikat aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë, analizë kjo që prezanton politikat e dhëna nga aspekti gjinor, duke i inkorporuar edhe analizat buxhetore. Analiza mund të gjendet në ueb faqen:

<http://mtsp.gov.mk/EBStorage/Files/Rodova%20Analiza%20Makedonski%2023%2002%202010.pdf>, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

merren parasysh pozitat e ndryshme të grave dhe burrave dhe pengesat e ndryshme që ata përballen, ndërsa në të njëjtën kohë duke krijuar kushtet në krijimin e më shumë programeve efikase, kurse fondet publike për të shpenzohen në mënyrë të përshtatshme.

Konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor Republika e Maqedonisë ka filluar ta promovojë në vitin 2008. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar më shumë aktivitete pilot për zbatimin e tij dhe ngritjen e vetëdijes te subjektet relevante për rëndësinë dhe dobitë për aplikimin e këtij koncepti. Në përputhje me Nenin 11 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave: „Organet e administratës shtetërore janë të obliguara që në kuadër të planeve dhe buxheteve të tyre strategjike ta përfshijnë parimin e mundësive të barabarta mes grave dhe burrave; t'i monitorojnë efektet dhe ndikimin e programeve të tyre për gratë dhe burrat dhe të informojnë në kuadër të raporteve të tyre vjetore.“ Për përfshirjen e komponentit gjinor në proceset e planifikimit dhe buxhetimit në programet dhe projektet e Qeverisë së RM-së, nevojitet kornizë e definuar me sferat strategjike të përfshira, synimet dhe aktivitetet për aplikim sistematik të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe përmbushjen e obligimit të lartpërmendur nga Ligji.

**Strategjia për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (SBPGJ)** është një dokument kombëtar që synon të promovojë barazinë gjinore dhe krijimin e mundësive të barabarta mes grave dhe burrave, duke përshtatur proceset aktuale të planifikimit dhe buxhetimit e politikave dhe programeve të shfrytëzuesve të buxhetit, duke marrë parasysh implikimet e ndryshme për gratë dhe burrat. Nevoja për miratimin e Strategjisë buron nga fakti që shumë shpesh paraqitet nevoja për të punuar ndryshe me gratë dhe burrat, të njihen dallimet dhe, gjithashtu, të zbatohen

masa për tejkalimin e pabarazisë dhe pengesave me të cilat ata ballafaqohen. Vendosja e perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel kombëtar dhe lokal do të çojë në ndarjen e duhur dhe të përgjegjshëm të fondeve, dhe transparencë më të mirë dhe përgjegjësi të buxhetit të shtetit nga aspekti i barazisë gjinore.

SBPGJ fokusohet në tre fusha strategjike: 1) aplikimi i perspektivës gjinore në programet dhe buxhetet e shfrytëzuesve të buxhetit në nivel qendror dhe lokal, 2) avancimi i kornizës ligjore për përfshirjen e buxhetimit gjinor të përgjegjshëm, dhe 3) përforcimi i mekanizmave institucionalë dhe ndërtimi i kapaciteteve nevojshme për përfshirjen e perspektivës gjinore në krijimin e politikave dhe programeve dhe buxheteve adekuate.

Korniza e Strategjisë përcakton sferat strategjike përmes qëllimeve të duhura strategjike, prej të cilave më pas nxirren aktivitetet, kornizat kohore, si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e të njëjtës. Arritja e rezultateve të përcaktuara, si ato cilësore dhe sasore, është shprehur me indikatorë adekuatë/treguesit e suksesit për matjen e shkallës së realizimit të saj. Strategjia, respektivisht aktivitetet e saj do të zbatohen nëpërmjet planeve operative vjetore.

Duke i ndjekur rekomandimet e Komisionit Evropian, OKB-së dhe të organizatave tjera ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë me realizimin e aktiviteteve në kuadër të Strategjisë, bashkohet me familjen e më shumë se 60 vende të botës që aplikojnë buxhetimin gjinor të përgjegjshëm në rrugë për të siguruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat dhe avancimin e barazisë gjinore.



## 1. Hyrje

Strategjia për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor vjen si rezultat i përpjekjeve të Qeverisë së RM-së për të përmirësuar efektivitetin e politikave dhe aktiviteve për avancimin e barazisë gjinore. Barazia ndërmjet burrave dhe grave është pjesë e korpusit të të drejtave të njeriut dhe i referohet trajtimit të barabartë në respektimin e të drejtave të parashikuara nga legjislacioni dhe politikat, por edhe në drejtim të ofrimit të mundësive të barabarta dhe përfitimet.

Aplikimi i konceptit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Republikën e Maqedonisë është përcaktuar në Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, si dhe në Planin kombëtar të veprimit për barazinë gjinore (2007-2012), një dokument strategjik i Qeverisë së RM-së, në të cilin janë paraqitur aktivitetet për realizimin e barazisë gjinore. Këto dokumente strategjike të Qeverisë së RM-së rrjedhin nga Platforma e Pekinit dhe Plani i veprimit, nga Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (KETGJFDG), Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit, përshtatja e legjislacionit në procesin e afrimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me përfundimin e kapaciteteve institucionale dhe mekanizmat për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat publike, strategjitë dhe planet e veprimit dhe përfshirja e metodave të buxhetimit gjinor në nivel kombëtar dhe lokal.

## 1.1. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor si vegël për përfshirjen e perspektivës gjinore në ngjarjet kryesore në shoqëri

Buxhetimi gjinor si një mjet relativisht i ri është pjesë e strategjive të Këshillit të Evropës dhe OKB-së, për përfshirjen e perspektivës gjinore në aktualitetet kryesore, politikat dhe praktikrat që kanë për qëllim arritjen e barazisë gjinore integrimi.<sup>2</sup>

Strategjitë për barazi gjinore miratohen me qëllim që të tejkalohen pabarazitë mes burrave dhe grave, që vijnë si rezultat i roleve të ndryshme shoqërore që ndikojnë ndryshe në detyrimet e tyre, mundësitë dhe përgjegjësitë në familje dhe shoqëri. Prandaj, nga përvoja e deritanishme në nivel global, u bë e qartë se për tejkalimin e pabarazive mes burrave dhe grave, qasja neutrale, sa i përket gjinisë, në politikrat dhe programet janë treguar si të pasuksesshme në një periudhë afatmesme apo afatgjate.

Interesi primar i strategjive për inkuadrimin e perspektivës gjinore në ngjarjet kryesore, janë rolet gjinore barazisë gjinore të cilat i referohen përgjegjësitë të ndryshme dhe marrëdhëniet midis burrave dhe grave, që në shoqëri janë definuar si adekuate për ata. Ata, në masë të madhe, i përcaktojnë nevojat e ndryshme, interesat dhe prioritetet e burrave dhe grave në sferën ekonomike, politike dhe sociale në shoqëri. Prandaj, ky model lejon që të perceptohet që disa nevoja të caktuara dhe prioritetet të burrave dhe grave janë të ndryshme dhe duhet të trajtohen ndryshe, me qëllim që burrat dhe gratë mund të nxjerrin dobi të njëjtë.

---

<sup>2</sup> Më shumë informacione mund të gjenden në:

Për këto arsye, gjithnjë e më shumë braktiset bindja se programe të veçanta për të mbështetur gratë janë të mjaftueshme që të tejkalohen pabarazitë që ekzistojnë në shoqëri dhe aplikohet një strategji për përfshirjen e perspektivës gjinore në ngjarjet aktuale. Kështu, nevojat dhe përvojat e burrave dhe grave bëhen një pjesë integrale në projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e buxheteve, të politikave dhe programeve në të gjitha fushat, me qëllim që gratë dhe burrat të kenë dobi të barabartë prej tyre.

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i Qeverisë së RM-së dhe në këtë kuptim është mjete më i fuqishëm në transformimin e shoqërisë, e cila mund t'u përgjigjet nevojave të grupeve të ndryshme. Me rëndësi të veçantë është të theksohet se Buxheti nuk është mjete i vetëm ekonomik, por se i njëjti i përmbledh politikat qeveritare dhe i reflektojnë prioritetet e qeverive. Buxhetet, në këtë kuptim, nuk janë neutrale sa i përket gjinisë. Ato ndikojnë te burrat dhe gratë në mënyra të ndryshme, e pasqyrojnë shpërndarjen e fuqisë në shoqëri, pabarazitë sociale dhe ekonomike dhe rolet e ndryshme sociale që burrat dhe gratë i kanë.

Prandaj, politikat buxhetore mund të kenë dallime të rëndësishme sa i përket ndikimit ndaj burrave dhe grave dhe te grupet e ndryshme të burrave dhe grave.

Praktikat e mira nënkuptojnë mirëkuptim për ndikimin e politikave dhe mënyrave në bazë të të cilave ato mund të formulohen më mirë, me qëllim që të arrihen rezultate dhe për të përmbushur nevojat e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, si dhe grupeve të ndryshme të njerëzve, gra dhe fëmijë.

Kundrejt qasjes tradicionale, që nënkupton ndërhyrje në politikat publike nëpërmjet alokimit të fondeve për programet specifike, që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes së gruas, trajnime për gratë apo ndoshta mbështetje për organizata të veçanta ose institucione, qasja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, siç është propozuar në këtë strategji, përfshin përdoruesit e buxhetit brenda kompetencave të tyre të përfshijnë perspektivën gjinore në krijimin e politikave, planeve strategjike dhe buxheteve, si dhe monitorimin e efekteve të saj, që t'i marrin në konsideratë ndryshimet në statusin socioekonomik dhe politik të grave dhe burrave. Pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për bujqësi, shëndetësi, arsim apo politikë sociale, politikat shpesh i neglizhojnë efektet mbi burrat dhe gratë nën maskën e „egalitë“ ose shpërndarjes së barabartë për të gjithë. Megjithatë, mjaft e mundshme është që programet qeveritare në sektorë të ndryshëm kanë efekte të ndryshme pozitive apo negative për gratë dhe burrat, në fuqinë e tyre ekonomike dhe standardin e jetesës.

Përfitimet kryesore nga strategjitë për buxhetimin gjinor, të cilat zbatohen në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, janë në drejtim të përmbushjes së një konteksti më të gjerë makroekonomik, që rrjedhin nga parimet dhe objektivat e Deklaratës së Lisbonës, e cila është zhvillimi i kapitalit njerëzor si strategji afatgjate që synon ndërtimin e shoqërive konkurruese, bazuar në dituri.

Vetë shtetet anëtare të BE-së e kanë identifikuar nevojën dhe përfitimet e zbatimit të politikave dhe strategjive për barazi gjinore, që kontribuojnë për:

- Përgjegjësinë e avancuar të autoriteteve qeveritare dhe përfaqësuesve të tyre në lidhje me barazinë gjinore;
- Efikasitetin e avancuar të politikave dhe programeve, duke siguruar se ata që kanë nevojë për ndihmë, kanë përfituar nga shpenzimet publike;
- Parimet e avancuara të menaxhimit të cilat përfshijnë shpërndarjen e burimeve dhe shërbimeve për popullatën në një mënyrë të drejtë, të barabartë, efikase dhe të përgjegjshme,
- Transparencën e avancuar të autoriteteve qeveritare, duke monitoruar shpërndarjen e fondeve dhe mënyrën si ato janë shpenzuar.

Nga ana tjetër, BPGJ mundëson që gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave, të merret në konsideratë edhe gjendja e ndryshme e burrave dhe grave dhe pengesat e ndryshme të cilëve u pamundësojnë që nën kushte të barabarta të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Kjo mundëson që politikat të fokusohen tek përfituesit konkret dhe te nevojat e tyre, me çfarë krijohen programe më efikase, kurse fondet publike të shpenzohen në mënyrë më të përshtatshme.

Më tej, BPGJ kontribuon që të arrihet një zhvillim i barabartë i shoqërisë, përmes sigurimit të pjesëmarrjes dhe përmbushjes së nevojave të burrave dhe grave, që në këtë mënyrë ata do të mund të japin kontribut më të madh.

Me aplikimin e buxhetimit gjinor rritet ndërgjegjësimi i aktorëve të ndryshëm për çështjet gjinore dhe ndikimin gjinor ndaj buxhetit dhe politikave. Kjo çon në rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë, për shkak se përmes politikës buxhetore ajo shpreh angazhimin për barazi gjinore. Buxhetet dhe politikat janë të përshtatur me nevojat aktuale të grave dhe

burrave, me çfarë avancohet barazia gjinore në shoqëri. Me buxhetimin gjinor të përgjegjshëm, gjithashtu bëhet i dukshëm kontributi, ndonëse jo sa duhet i njohur, i grave. Pra, kjo tregon vlerën e punës së papaguar të grave dhe aktivitetet që ato i kryejnë (kujdesi për familjen, kujdesi për anëtarët e sëmurë të familjes dhe anëtarët me aftësi të kufizuara, pra e ashtuquajtura ekonomi e vëmendjes dhe të kujdesit), që duhet të shihen si faktor thelbësor gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave.

## 1.2. Terminologjia dhe termet e përgjithshme

1. **Mundësitë e barabarta të grave dhe burrave** është promovimi i parimit të aplikimit të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e sektorit publik dhe privat, status dhe trajtim të barabartë në realizimin e të gjitha të drejtave dhe në zhvillimin e potencialeve individuale, përmes të cilave këto kontribuojnë për zhvillim shoqëror, si dhe përfitime të barabarta nga rezultatet e dala nga ky zhvillim;
2. **Trajtimi i barabartë** është mungesa e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të bazuar në gjini, në pajtim me LMB ose ligj tjetër;
3. **Diskriminimi në bazë të gjinisë** është çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë të gjinisë, që ka efekt ose qëllim të kanosë njohjen, realizimin ose ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mbi bazën e barazisë midis grave dhe burrave në sferën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile ose në çdo fushe tjetër, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, anëtarësia në një grup të

margjinalizuar, etnia, gjuha, kombësi, origjina shoqërore, religjioni apo besimi fetar, arsimi, përkatësia politike, statusi personal apo social, paaftësia fizike apo mendore, moshja, gjendja martesore apo familjare, statusi i pronës, gjendja mjekësore ose ndonjë arsye të tjera;<sup>3</sup>

#### **4. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim**

Në Konferencën e katërt botërore për gratë, e organizuar nga OKB-ja në Pekin, RP e Kinës, në shtator të vitit 1995 u miratua Deklarata (e njohur si Deklarata e Pekinit) dhe Platforma për Veprim. Me miratimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, bashkësia ndërkombëtare është e angazhuar për të përmirësuar statusin e grave dhe për të forcuar jetën e tyre publike dhe private. Shtetet anëtare të OKB-së, duke përfshirë edhe Maqedoninë, morën përsipër zbatimin e Platformës për Veprim, e cila përfshinë fushat e interesit të veçantë për gratë. Sferat kanë të bëjnë me: gratë dhe varfërinë, edukimin, gratë dhe shëndetin, dhunën, gratë në konfliktet e armatosura, gratë dhe ekonominë, gratë dhe fuqia dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje, mekanizmat institucionalë për të forcuar gratë, gratë dhe të drejtat e njeriut, gratë dhe mediat, gratë dhe mjedisin, si dhe kujdesin për fëmijët e gjinisë femërore.

#### **5. Barazia gjinore**

Barazia gjinore do të thotë paanësi gjatë trajtimit të burrave dhe grave, sipas nevojave të tyre personale, drejtësi veçanërisht në lidhje me të drejtat, përfitimet, detyrimet dhe mundësitë. Barazia gjinore ka të bëjë me avancimin e barazisë personale, sociale, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë.

---

<sup>3</sup> Definimi i termeve nën 1, 2 dhe 3, janë marrë nga LMBGB

## 6. Barazia gjinore

Barazia gjinore do të thotë se sjelljet e ndryshme, aspiratat, nevojat e grave dhe burrave janë respektuar, janë konsideruar, vlerësuar dhe mbështetur në mënyrë të barabartë. Kjo do të thotë se të drejtat e tyre, përgjegjësitë dhe mundësitë nuk do të varen nëse ata ishin lindur si një burrë apo grua. Ajo bazohet në parimet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale. Është e qartë se barazia gjinore dhe përforcimi i grave është esenciale për t'iu referuar shqetësimit kryesor të varfërisë dhe pasigurisë dhe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor si qendër.

## 7. Perspektiva gjinore

Perspektiva gjinore është pikëpamje e dallimeve gjinore në çdo fushë të caktuar politikash/aktivitet - pranimi i përgjithshëm i perspektivës gjinore në procesin e vlerësimit të implikimeve të çdo veprimi të planifikuar për gratë dhe burrat, duke përfshirë legjisllacionin, politikat apo programet në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Kjo është strategji për çështjet dhe përvojat e grave dhe burrave në përpjekjen e tyre të bëhet dimension integral i projektimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore në mënyrë që gratë dhe burrat do të kenë përfitime të barabarta dhe nuk do të vazhdohet me pabarazinë. Qëllimi final është arritja e barazisë gjinore.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Definicionet janë marrë nga The Economic and Social Council of United Nations, 1997)



**8. Integrimi i barazisë gjinore në politikat, praktikat dhe ngjarjet kryesore (Gender mainstreaming)** paraqet integrimin e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit të ndërtimit, të vendimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave, duke marrë në konsideratë promovimin dhe avancimin e barazisë midis grave dhe burrave. Kjo do të thotë vlerësim i asaj se si politikat ndikojnë në jetën dhe vendin e grave dhe burrave, si dhe marrja e përgjegjësisë që të njëjtat të adresohen duke krijuar hapësirë për të gjithë, nga niveli i bashkësisë së familjes deri në nivelin e bashkësisë më të gjerë për të kontribuar në procesin e ndërtimit të përbashkët dhe kuptohet vizion për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke i shndërruar këto politika në realitet. Për t'u arritur kjo, nevojitet nivel i lartë i vullnetit politik, përkushtim dhe mirëkuptim në të gjitha strukturat dhe sferat e shoqërisë.

### **9. Buxhete gjinore të përgjegjshme**

Buxhete gjinore të përgjegjshme është reflektim i vullnetit politik dhe hapat e ndërmarra në arritjen e barazisë gjinore, duke aplikuar praktikat e perspektivës gjinore në proceset e buxhetimit. Kjo nuk implikon buxhete të veçanta apostafat për gra, por kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga aspekti i barazisë gjinore dhe përfshirja e perspektivave gjinore në të gjitha nivelet në proceset e buxhetimit.<sup>5</sup>

### **10. Politikat neutrale gjinore**

Politikat që krijohen me supozimin se objektivat dhe instrumentet e një politike të caktuar janë gjerësisht të aplikueshme, duke mos i marrë parasysh efektet (e mundshme) e ndryshme që ajo politikë mund të ketë mbi gratë dhe burrat.

<sup>5</sup> Definimi i termeve prej 4-9 janë marrë nga NPARR

## **11. Buxheti**

Buxheti paraqet akt, me anë të të cilit planifikohen të ardhurat vjetore dhe të hyra tjera dhe fonde të miratuara dhe i përfshin buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve.

## **12. Planifikimi strategjik**

Planifikimi strategjik është një proces që përcakton prioritetet dhe objektivat që konsiderohen më të rëndësishme, përcakton programet, projektet dhe aktivitetet, përmes të cilave do të realizohen prioritetet e definuara dhe të përcaktohen burimet e nevojshme për zbatimin e prioritetëve përmes procesit të buxhetit.

## **1.3. Metodologjia dhe qasja në përpilimin e Strategjisë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor**

Përgatitja e Strategjisë për buxhetimin gjinor është pjesë e projektit që Ministria e punës dhe politikës sociale e realizon me mbështetjen teknike dhe financiare të UN WOMEN - organ i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe përforcimin e grave, Zyra e projektimit në Shkup.

Për përgatitjen e projekt-tekstit të Strategjisë mbi buxhetimin gjinor, u formua një grup punues me përfaqësuesit e emëruar të Ministrisë së punës dhe politikës sociale (me përfaqësues të Departamentit të buxhetit, nga Departamenti i planifikimit strategjik, Departamenti i punës, Departamenti për mundësi të barabarta dhe nga Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë), të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe administrimit të ujërave (me përfaqësues të Departamentit të zhvillimit rural dhe Departamentit për planifikim strategjik), Ministrisë së financave, Sekretariatit të përgjithshëm i Qeverisë

së Republikës së Maqedonisë, përfaqësues nga Qyteti i Shkupit, një ekspert i pavarur – anëtar i grupit të punës nga projekti i mëparshëm, si dhe përfaqësues nga UN EËOMEN.

Në fazën e përgatitjes ishin organizuar dy sesione trajnimi dhe tre takime pune të përfaqësuesve të grupit të punës, ku me mbështetjen e një eksperti ndërkombëtar, përvojën e të cilit, e kanë shfrytëzuar disa shteteve anëtare të BE-së dhe vende nga rajoni, si dhe një ekspert lokal, u përcaktuan sferat strategjike, objektivat dhe aktivitetet për implementimin e buxhetimit gjinor në Republikën e Maqedonisë. Për më tepër, Parlamentin e Republikës së Maqedonisë u zhvillua një seminar ndërkombëtar lidhur me buxhetimin gjinor me Komisionin për mundësi të barabarta dhe Klubin e parlamentareve.

Në përgatitjen e projekt-tekstit të Strategjisë mbi buxhetimin gjinor, kontribut të madh kanë dhënë deputetët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, përmes takimit të Komisionit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, e cila i dha përkrahje unanime kësaj Strategjie, si dhe institucionet shtetërore, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, pjesëmarrës të tre seancave publike rajonale të mbajtur në Manastir, Strumicë dhe Shkup, duke përfshirë takimet konsultative shtesë. Të gjitha sugjerimet dhe propozimet konstruktive janë integruar në strategjinë mbi buxhetimin gjinor.

#### **1.4. Synimi kryesor i Strategjisë**

Strategjia për buxhetimin gjinor synon krijimin e politikave të përgjegjshme sa i përket gjinisë, në drejtim të reduktimit të pabarazisë dhe promovimin e mundësive të barabarta në pajtim me nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, nëpërmjet një procesi të koordinuar dhe transparent të buxhetimit gjinor.

## 2. Konteksti

### 2.1. Pasqyrim i përgjithshëm i gjendjes – domosdoshmëria për ndërlidhjen e procesit të buxhetimit dhe barazisë gjinore

Barazia e të gjithë qytetarëve në drejtim të lirive dhe të drejtave, pavarësisht nga gjinia e tyre, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja etnike ose sociale, besimet politike ose fetare dhe pozita shoqërore paraqet vlerë themelore e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Përveç Kushtetutës, barazia gjinore është rregulluar me akte të tjera ligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare, që janë një pjesë integrale e sistemit tonë ligjor. Me miratimin e Ligjit për mundësi të barabarta rregullohet krijimi i mundësive të barabarta dhe trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në sferën politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore, shëndetësore, civile dhe çdo sferë tjetër të jetës shoqërore. Ligji thotë se krijimi i mundësive të barabarta është një shqetësim i të gjithë shoqërisë, pra i të gjitha subjekteve në sektorin publik dhe privat, me çfarë mënjanohe pengesat dhe krijohen kushtet për arritjen e barazisë së plotë ndërmjet grave dhe burrave. Duke përcaktuar përgjegjësitë e palëve përgjegjëse, në Ligj jepet baza ligjore për aplikimin futjen e buxhetimit të përgjegjshëm sa i përket gjinisë.

Përpjekjet në më shumë dekada për të gjetur mënyrat më efektive nëpërmjet së cilave angazhimet politike për barazinë gjinore si të përfshira në legjislacionin kombëtar, dhe në dokumente të shumta ndërkombëtare, do të zbatohet në praktikë, treguan se këto përpjekje mund të zbatohet me sukses vetëm nëse parimi i barazisë gjinore në mënyrë konsekuente integrohet në të gjitha politikat publike dhe në qoftë se e gjithë shoqëria merr përgjegjësinë për arritjen e barazisë gjinore. Një nga metodat për arritjen e këtij qëllimi është edhe buxheti i

përgjegjshëm gjinor, i cili edhe pse ende është risi, është duke u bërë praktikë e përhapur, si në nivel global, po ashtu edhe te ne.

Kur bëhet fjalë për përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore, e shprehur përmes procesit të buxhetit, duhet të fillojë me programet qeveritare dhe prioritetet strategjike, sepse është hapi i parë drejt përcaktimit të aktiviteteve të financuara nga buxheti i RM-së. Programet qeveritare në sektorë të ndryshëm ndikojnë në mënyra të ndryshme të burrat dhe gratë, në fuqinë e tyre ekonomike dhe standardin e jetesës.

Përfshirja e plotë e çështjeve gjinore në trendet shoqërore do të arrihet vetëm nëse programet, prioritetet strategjike dhe objektivat do të ndërlihen me çështjet gjinore, ose në qoftë se tek këto programe dhe prioritete strategjike futet komponenti gjinor<sup>6</sup>. Prioritetet i shprehin rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen në afat të mesëm dhe të gjatë. Aplikimi dhe shprehja e komponentit gjinor si pjesë e një rezultati të përgjithshëm, më tej mund të përpilohen në qëllimet strategjike përmes

---

<sup>6</sup> Si shembull mund të merret Programi qeveritar – *Masat për rritjen e punësimit dhe standardit të jetës*, dhe në mënyrë analoge, Prioriteti qeveritar – *Rritja ekonomike dhe konkurrenca në bazë afatgjate, shkalla më e lartë e punësimit, rritja e standardit të jetës dhe cilësia e jetesës* dhe Synimi strategjik – *Zbatimi i politikave aktive për punësim* me anë të të cilave veprohet në bazë të diturive dhe kualifikimeve për ofertën e fuqisë punëtore. Nëse këtu futet aspekti gjinor, por gjatë kësaj do më ndryshojnë qëllimi dhe rëndësia, të njëjtat do të ishin quajtur – *Masat për rritjen e punësimit dhe standardit të jetës të burrave dhe grave, respektivisht Rritja ekonomike dhe konkurrenca në bazë afatgjatë, shkalla më e lartë e punësimit të burrave dhe grave, rritja e standardit të jetesës dhe cilësisë së jetesës të burrave, grave, djemve dhe vajzave* dhe *Zbatimi i politikave aktive për punësimin e burrave dhe grave* me anë të të cilave veprohet në bazë të diturive dhe kualifikimeve për ofertën e fuqisë punëtore. Programet e definuara në këtë mënyrë, prioritetet strategjike dhe synimet e Qeverisë së RM-së do të kontribuojnë për përcaktimin e aktiviteteve konkrete (projekte) për çdo shfrytëzues buxheti, që njëherësh do të jenë senzitiv sa i përket gjinisë.

rezultateve konkrete, specifike dhe reale në kornizë specifikuar kohore.

Përpos programeve qeveritare, prioriteteve dhe objektivave si prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së, si pika hyrëse për aplikimin e perspektivës gjinore, respektivisht buxhetimin e përgjegjshëm sa i përket gjinisë, identifikohen edhe planet strategjike dhe Qarkorja buxhetore.

Në procesin e planifikimit strategjik, përdoruesit e buxhetit duhet të identifikojnë projektet ose aktivitetet brenda juridiksionit të tyre të cilët kanë kontakt me përfshirjen e çështjeve gjinore në trendet sociale. Pasi këto aktivitete të jenë identifikuar, ata duhet të krijohen në formën e aktiviteteve të integruara nëpërmjet programeve, projekteve ose aktiviteteve në planet strategjike dhe Plan-programet e zhvillimit të planit dhe Qarkoren buxhetore, dhe të njëjtat duhet të përcaktohen duke përfshirë indikatorët e ndjeshëm gjinorë përmes të cilëve do të maten rezultatet nga aktivitetet e realizuara. Me këtë identifikim të aktiviteteve do të mundësohet monitorimi nga afër të efekteve të tyre.

Dallimet midis burrave dhe grave mbeten të panjohura në procesin e përgjithshëm të planifikimit strategjik dhe buxhetimit për shkak të supozimit se objektivat dhe instrumentet e politikës ekonomike janë gjerësisht të zbatueshme dhe me këtë janë neutrale sa i përket gjinisë. Prandaj, për zbatimin e procesit të buxhetimit gjinor, rol të përgjegjshëm aktiv ka Ministria e punës dhe politikës sociale, përmes Sektorit për mundësi të barabarta si ministri në juridiksionin e të cilave përfshin çështjen e barazisë gjinore. Rol qendror për zbatimin e plotë të Strategjisë për BPGJ ka edhe Ministria e financave, veçanërisht Sektori i buxheteve dhe

fondeve, që janë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen e Strategjisë fiskale dhe buxhetit të RM-së. Në bashkëpunim të ndërsjellë në mes të Sektorit për mundësi të barabarta brenda Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe Sektorit për buxhete dhe fonde të Ministrisë së financave do të bëhen ndryshime konkrete në Qarkoren buxhetore. Pa dyshim këtu vjen në shprehje edhe roli i Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë së RM-së, roli i të cilit është vendimtar në përcaktimin dhe promovimin e qasjes rreth se cilat aktivitete, respektivisht projekte janë të ndjeshme sa i përket gjinisë dhe si të formulohen dhe monitorohen indikatorët e ngjeshëm gjinor në procesin e planifikimi strategjik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh se një nga parakushtet themelore për zbatimin e buxhetimit gjinor është ekzistenca e të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë. Me ato mund të përmirësohen proceset e programimit dhe planifikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave. Kjo do të ndihmojë, pas zbatimit të buxhetit, për të matur efektet që këto politika kanë pasur te shfrytëzuesit e ndryshëm.

Duke pasur parasysh faktin se Buxheti është pjesë operative e politikave publike, me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe duke përfshirë edhe aspektin e analizës gjinore të Buxhetit, në të vërtetë do të shqyrtohet sesa politikat publike janë të përgjegjshme sa i përket gjinisë dhe sa përcaktime parimore për barazi gjinore ndiqen realisht me alokimin adekuat të mjeteve buxhetore. Në këtë mënyrë do të shqyrtohet ndikimi i shpërndarjes së të ardhurave dhe shpenzimeve për statusin social të grave dhe burrave dhe do të tregojë për vendet potenciale që mund të jenë shkak i pabarazisë dhe ku është e nevojshme të kryhet rishpërndarja e mjeteve me qëllim që të arrihet barazi më të madhe gjinore. Thënë thjesht, me buxhetimin gjinor të përgjegjshëm nuk do të kërkohet fonde të

posaçme për gratë, e as ndarjen e mjeteve të barabarta për burrat dhe gratë, porse kjo do të shërbejë si mjet për ndarjen e barabartë të mjeteve në pajtim me nevojat specifike të burrave dhe grave.

## **2.2. Korniza juridike, institucionale dhe procesi i buxhetimit dhe planifikimit strategjik**

### **2.2.1. Barazia gjinore**

Pozita juridike dhe statusi i grave në Republikën e Maqedonisë janë të rregulluara me Kushtetutë, si akti më i lartë juridik në shtet, si dhe në një numër të madh të ligjeve, në të cilat është inkorporuar perspektiva gjinore. Përveç legjislacionit të brendshëm, këto çështje janë të rregulluara nga marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar dhe ratifikuar, dhe që në bazë të nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, janë pjesë integrale e rendit tonë juridik. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në dispozitat e saj themelore, i numëron liritë themelore dhe të drejtat e njeriut dhe liritë e njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë, si vlera më të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore, respektivisht, si vlera themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Për më tepër, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit zënë një vend qendror në pjesën normative të Kushtetutës. Këtu veçanërisht duhet të përmendet neni 9 i Kushtetutës së RM-së, sipas të cilit të gjithë qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, origjina kombëtare ose sociale, bindjet politike ose fetare dhe statusi social. Ky nen



përcakton se shtetasit janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

Deri në vitin 2006 Republika e Maqedonisë nuk kishte ligj të përgjithshëm që të rregullojë çështjen e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Në maj të vitit 2006 Parlamenti i Republikës së Maqedonisë miratoi Ligjin e parë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, me të cilin u promovuan parimet e krijimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në fushën politike, ekonomike, sociale, arsimore, si në fusha të tjera nga jeta shoqërore. Me miratimin e Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, Republika e Maqedonisë e ka përmbushur detyrimin për të miratuar masat e duhura legislative dhe të tjera, duke përfshirë edhe sanksione, me të cilat ndalohet të gjitha llojet e diskriminimit të grave, në përputhje me kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare. Në vitin 2012 Parlamenti i RM-së e miratoi ligjin e dytë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, me të cilin ligj u avancua korniza juridike në drejtim të krijimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Ky ligj është i një rëndësie të veçantë për aplikimin e buxhetimit gjinor të përgjegjshëm, si një proces që duhet të përfshihet në operacionet e përditshme të subjekteve përgjegjëse. Në fakt, në përcaktimin e përgjegjësisë të subjekteve përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal është përcaktuar edhe përfshirja e perspektivës gjinore në planifikimin dhe buxhetimin.

Është e nevojshme të theksohen përpjekjet e Qeverisë së RM-së në avancimin e statusit të grave. Plani kombëtar i veprimit për barazi gjinore, si një dokument strategjik i Qeverisë së RM-së, e njeh buxhetimin gjinor si mjet për të përmirësuar statusin e grave dhe sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm në realizimin e barazisë gjinore.

## 2.2.2. Korniza institucionale dhe kompetencat e subjekteve përgjegjëse lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

Korniza juridike, respektivisht subjektet kompetente dhe roli i tyre lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, janë definuar në Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

### Ministria e punës dhe politikës sociale

Mekanizmi qeveritar për barazi gjinore është themeluar në Ministrinë e punës dhe politikës sociale. Në vitin 1997, me vendimin e Qeverisë, është themeluar Departamenti për avancimin e barazisë gjinore në Sektorin e punës - Ministria e punës dhe politikës sociale. Në mars të vitit 2007 statusi i departamentit u avancua dhe me Aktin e sistematizimit dhe organizimit të Ministrisë së punës dhe politikës sociale është themeluar Sektori për mundësi të barabarta. Ky sektor përbëhet prej dy departamenteve (njësi) - Departamenti i barazisë gjinore dhe Departamenti për parandalimin dhe mbrojtjen kundër çdo lloj diskriminimi.

Në përputhje me LMB, roli i Ministrisë së punës dhe politikës sociale, përmes punës së Sektorit, është:

Të kujdeset për avancimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha sferat e jetës shoqërore, që të aplikojë parimin e **mundësive të barabarta në rrjedhat kryesore të riorganizimit, avancimit, zhvillimit dhe vlerësimit** të proceseve politike në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e nivelit kombëtar dhe lokal, për të dhënë mendimin e vet për propozimet për miratimin e masave themelore dhe të veçanta për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat dhe të monitorojnë zbatimin e tyre, si dhe të bashkëpunojë me

Komisionin për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë gjatë përpilimit të ligjeve, dokumenteve strategjike dhe raporteve, të parashtrojë në Qeveri ose ministritë kompetente propozime për miratimin apo ndryshimin ose plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera relevante në krijimin e mundësive të barabarta, si dhe detyrime të tjera (të vendit dhe ndërkombëtare) që rrjedhin nga LMB (Ligji për mundësi të barabarta).

### **Parlamenti i Republikës së Maqedonisë – Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave**

Parlamenti i Republikës së Maqedonisë, në kuadër të kompetencave të veta, kujdeset për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në baza të gjinisë dhe përmirësimin e statusit social të grave; e integron parimin e shanseve të barabarta të grave dhe burrave në iniciativat ligjore, politikat dhe programet; organizon diskutime dhe debate publike për çështje që kanë të bëjnë me shanset e barabarta të grave dhe burrave; i analizon dhe jep mendim për ndikimin e dispozitave ligjore mbi statusin e grave dhe burrave; kërkon raporte dhe dokumentim nga institucionet kompetente lidhur me sferën e punës dhe përpilon dhe publikon raporte për punën e vet.

Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në Parlamentin e Maqedonisë, si trup punues i Parlamentit të RM-së, ndër kompetencat tjera, duhet të shqyrtojë edhe Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe propozim-ligje tjera dhe dispozita tjera nga aspekti i përfshirjes së konceptit gjinor në të.

## Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Qeveria e Republikës së Maqedonisë kujdeset për avancimin dhe aplikimin e mundësive të barabarta dhe për arritjen e qëllimeve të LMB, duke zbatuar masat themelore dhe të veçanta që janë përcaktuar me ligj.

Prandaj, Qeveria e RM-së emëron koordinator dhe zv. koordinator për mundësi të barabarta dhe e monitoron zbatimin e parimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave në **planet strategjike të ministrive gjegjëse dhe buxhetet**, që bashkëpunojnë me Ministrinë e punës dhe politikës sociale.

## Organet e administratës shtetërore

Organet e administratës shtetërore janë të obliguara që në kuadër të kompetencave të tyre t'i promovojnë dhe avancojnë mundësitë e barabarta duke ndërmarrë masat themelore dhe ato të veçanta. Prandaj, Organet e administratës shtetërore (OASH) caktojnë punonjës zyrtar – koordinator dhe zv. koordinator, të cilët do t'i koordinojnë punët që janë në kompetencë të organit shtetëror, për aplikimin e mundësive të barabarta.

Organet e administratës shtetërore janë të obliguara që në kuadër të **planeve strategjike të tyre dhe buxheteve** ta inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave, **t'i monitorojnë efektet dhe ndikimin** e programeve të tyre nga gratë dhe burrat, si dhe të informojnë në kuadër të raporteve të tyre vjetore.

## Njësitë e vetëqeverisjes lokale

Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të obliguara që (autoritetet qendrore mund t'u rekomandojnë lidhur me nevojën e njëjësive

për vetëqeverisje lokale – e jo t’u japë për detyrë) të respektojnë parimin e mundësive të barabarta dhe t’i promovojnë dhe avancojnë mundësitë e barabarta të grave dhe burrave duke ndërmarrë masat themelore dhe të veçanta. Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të obliguara që të themelojnë Komision për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, si trup i përhershëm – me vendim të Këshillit të Njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe të caktojnë koordinator për mundësi të barabarta të grave dhe burrave nga radhët e nëpunësve shtetërorë në njësinë e vetëqeverisjes lokale.

Në kuadër të kompetencave të tyre, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të obliguara që në kuadër të **planeve strategjike dhe buxheteve** të tyre të inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave, si dhe **t’i monitorojnë efektet dhe ndikimin e** programeve të tyre ndaj grave dhe burrave dhe të informojnë në kuadër të raporteve të tyre vjetore.

## Prezantimi i të dhënave statistikore

Në bazë të nenit 18 nga LMB, Parlamenti dhe Qeveria e RM-së, organet e administratës shtetërore, organet e gjyqësisë dhe organet tjera shtetërore, organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale, personave juridikë – të cilëve me ligj u është besuar kryerja e veprimtarive me interes publik, shoqatat, fondacionet, ndërmarrjet publike, entet arsimore, entet e mbrojtjes sociale, entet e shëndetit, partitë politike, mjetet e informimit publik, shoqatat tregtare dhe subjektet tjera të cilat me ligj janë të obliguara të grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, janë të detyruar që t’i prezantojnë këto të dhëna në bazë të përkatësisë gjinore dhe t’i dorëzojnë në Entin shtetëror të statistikës.

### 2.2.3. Procesi i buxhetimit dhe planifikimi strategjik

Kur bëhet fjalë për procesin e buxhetimit në RM, është një proces kompleks i përbërë nga proceset e shumta të ndërlidhura dhe të ndërvarura, që në asnjë rast nuk mund të konsiderohen si aktivitete të veçanta. Përgatitja dhe miratimi i Buxhetit të RM-së për vitin aktual nuk është një aktivitet që fillon dhe mbaron në një vit kalendarik, respektivisht fiskal të dhënë, por, përkundrazi, është një proces që ndodh në disa vite kalendarike, edhe pse të ardhurat dhe shpenzimet e tyre janë të lidhura në mënyrë rigoroze për vitin e dhënë fiskal. Viti fiskal në RM përputhet me vitin kalendarik, që fillon prej 1 janarit deri më 31 dhjetor.

Procesi i buxhetimit për vitin aktual (n) fillon në vitin e kaluar (n-1) me miratimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë, kurse përfundon në vitin (n+1), respektivisht pas miratimit të Raportit revizor përfundimtar nga Enti shtetëror i revizionit (ESHR), pas revizionit të kryer të Buxhetit themelor të RM-së, aktivitet ky që është obligativ në planin e punës të ESHR-së. ESHR përpilon raportin e revizionit pas përfundimit të vitit fiskal dhe para miratimit të Buxhetit të RM-së nga Parlamenti, respektivisht më së voni deri më 30 qershor në vitin aktual për vitin e kaluar fiskal.

Ligji i Buxheteve e rregullon procedurën për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Buxhetit të RM-së dhe buxhetet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale dhe të Qytetit të Shkupit. Me Ligjin e buxheteve është përcaktuar afati kohor për miratimin e dokumenteve, në bazë të të cilave përgatitet Buxheti i shtetit. Afati i njëjtë është zhvilluar më tej në Metodologjinë për planifikim strategjik dhe përgatitjen e Programit vjetor të punës

së Qeverisë, e cila i përcakton fazat dhe procedurat në procesin e planifikimit strategjik, dhe lidhja e tyre me procesin e buxhetit.

Baza për përpilimin e buxheteve janë: prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së, strategjia fiskale, propozim-projektet strategjike të shfrytëzuesve të buxhetit dhe politika buxhetore dhe prioritetet e komunave.

Prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së janë kapislat fillestare që e përcakton përmbajtjen e Buxhetit të shtetit për vitin aktual fiskal, kurse duke filluar prej vitit 2009, me aplikimin e pjesës zhvillimore të Buxhetit, jepen edhe synimet edhe për dy vitet e ardhshme.

Me Vendim për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë, më së voni deri më 15 prill të vitit aktual, Qeveria e RM-së i miraton prioritetet strategjike dhe synimet për vitin e ardhshëm. Vendimi për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së RM-së publikohen në Gazetën Zyrtare të RM-së dhe të njëjtat domosdo respektohen si të tilla sipas formës dhe përmbajtjes nga ana e shfrytëzuesve të buxhetit. Prioritetet strategjike, si përmbledhje e synimeve dhe iniciativave, shfrytëzuesit e buxhetit të autoriteteve qendrore dhe fondet, në mënyrë obliguese i përfshijnë në buxhetet e tyre përmes programeve qeveritare dhe nën-programeve.

Pas marrjes së vendimit për prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së, Ministria e financave përgatit strategji afatmesme fiskale për një periudhë prej tre viteve, në të cilën jepen udhëzime dhe synime të politikës fiskale, dhe gjithashtu e vlerëson sasinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e dhënë. Me Strategjinë fiskale përcaktohen parashikimet fiskale për tre vitet e ardhshme, vendoset kufiri i shpenzimeve totale në

bazë të bilancit buxhetor dhe deficitit të planifikuar, dhe parashikimi i të ardhurave.

Strategjia fiskale si një dokument bazë strategjik është bazë për përgatitjen e Buxhetit për vitin përkatës. Ministria e Financave në bazë të Strategjisë fiskale Qeverisë së RM-së i propozon mjetet maksimale të miratuara (kufizimet buxhetore) për tri vitet e ardhshme për shfrytëzuesit e buxhetit të pushtetit qendror dhe për fondet. Limitet buxhetore u dorëzohen shfrytëzuesve të buxhetit me Qarkoren Buxhetore.

Propozim-strategjia fiskale me shumat maksimale të përcaktuara të mjeteve të miratuara për çdo shfrytëzues buxhetor përpilohet në periudhën prill-maj, kurse Qeveria e miraton më së voni deri më 31 maj.

Bazuar në Strategjinë afatmesme fiskale dhe shumat maksimale të përcaktuara të mjeteve të miratuara, Ministria e financave jo më vonë se 15 qershor, deri te shfrytëzuesit e buxhetit në pushtetit qendror dhe fondet jep udhëzime në formën e Qarkores Buxhetore për dorëzimin e kërkesave për përgatitjen e projekt-buxhetit (kërkesat buxhetore). Lidhur me Njësitë e vetëqeverisjes lokale, Ministria e financave e dorëzon Qarkoren buxhetore deri më 30 shtator, kryetarit të komunës.

Planet strategjike janë më shumë dokumente të dedikuara (Plani strategjik është akt integruar zhvillimor i ministrisë) që reflektojnë prioritetet dhe qëllimet dhe objektivat e shfrytëzuesit buxhetor për një periudhë prej tre vjetësh. Ata janë përgatitur në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së RM-së, ndërsa në aspektin e sistemit integral të planifikimit dhe buxhetimit, projekt-plani strategjik është dokument shoqërues i kërkesave buxhetore.



Planet strategjike përpilohen në vitin aktual, në periudhën nga maji deri në gusht, që kanë të bëjnë për tre vitet e ardhshme. Planet përfshijnë rezultatet e arritura nga programet dhe projektet e shfrytëzuesve buxhetorë për vitin aktual dhe për vitin e kaluar. Analoge me këtë, planet japin rezultatet e pritura në programet dhe projektet e shfrytëzuesve buxhetorë për vitin aktual (kryesisht për periudhën nëntor-dhjetor), si dhe ato që kanë të bëjnë me periudhën e ardhshme trevjeçare.

Një kopje e propozim-planit strategjik dorëzohet Ministrisë së financave në shtojcën e kërkesës buxhetore, kurse një kopje dorëzohet Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë më së voni deri më 1 shtator.

Sekretariati i përgjithshëm kryen analizën e projekt-planeve strategjike në aspektin e përmbajtjes dhe formës, kurse në bashkëpunim me Sekretariatit për çështje evropiane analizon nëse aktivitetet e propozuara nga shfrytëzuesit buxhetorë kontribuojnë në realizimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Maqedonisë. Për Programet horizontale, nëse është e nevojshme, Sekretariati i përgjithshëm organizon bashkëpunimin ndërministror. Ministria e financave, megjithatë, i analizon planet e projekt-strategjike nga aspekti i justifikimit të fondeve të planifikuara për zbatimin e programeve, nën-programeve dhe projekteve dhe mundësive për sigurimin e tyre.

Propozim-përlllogaritjet buxhetore paraqesin kërkesa të mjeteve të shfrytëzuesve buxhetorë për financimin e programeve dhe projekteve të përfshira në planet e tyre strategjike.

Propozim-kërkesat buxhetore japin një pasqyrë detale për mënyrën se si shfrytëzuesit buxhetorë do t'i ndajnë resurset për

programet dhe projektet, që përfshihen në planet strategjike. Shfrytëzuesit buxhetorë janë të obliguar që propozim-kërkesat buxhetore t'i dorëzojnë në Ministrinë e financave deri më 1 shtator, në të kundërtën Ministria e financave do të hartojë propozim-buxhet në emër të tyre.

Afatet dhe procedurat për përpilimin dhe miratimin e Buxhetit të RM-së janë përcaktuar me Ligjin për buxhete. Përpilimi i propozim-buxhetit të RM-së është në kompetencë të Ministrisë së financave, derisa për përpilimin e buxhetit në vetëqeverisjen lokale përgjegjës është Kryetari i komunës.

Pas harmonizimeve të kryera me shfrytëzuesit buxhetorë, Ministria e financave më së voni deri më 1 nëntor ia dorëzon propozim-buxhetin Qeverisë së RM-së për miratim. Në propozim-buxhet prezantohet shuma e kërkuar nga shfrytëzuesit buxhetorë dhe shuma e propozuar nga Ministria e financave.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e shqyrton propozim-buxhetin dhe, në bazë të prioriteteve të përcaktuara strategjike dhe Strategjisë fiskale i përcakton shumat për çdo shfrytëzues buxhetor. Qeveria më së voni deri më 15 nëntor e dorëzon propozim-buxhetin në Parlamentin e RM-së.

Ministria e financave e propozon Propozim-buxhetin e RM-së në Parlament. Parlamenti i Republikës së Maqedonisë nuk mund ta shqyrtojë propozim-buxhetin para se të kalojnë 20 ditë nga dita kur i njëjti është dërguar në Parlament. Propozim-buxheti është i plotë dhe shqyrtohet në Komisionin parlamentar për financim dhe buxhet dhe në Komisionin juridiko-ligjvënës, por është bërë praktikë që edhe komisionet tjera ta shqyrtojnë propozim-buxhetin, secili komision në sferën e vet.

Deputetët përmes debateve publike dhe punën në komisionet parlamentare kanë mundësi të hapur të japin propozime, të propozojnë ndryshimin e propozim-buxhetit dhe Ligjit për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin përkatës. Çdo rritje e mjeteve të propozuara e që janë miratuar duhet të shoqërohet me uljen e duhur të mjeteve të tjera të propozuara. Parlamenti ka fjalën e fundit në miratimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe të masave për grumbullimin e të ardhurave buxhetore para se formalisht të bëhen pjesë e Buxhetit të RM-së për vitin e ardhshëm. Parlamenti e miraton Buxhetin më së voni deri më 31 dhjetor.

### **3. Strategjia për buxhetim gjinor të përgjegjshëm**

Strategjia për buxhetim gjinor të përgjegjshëm i përcakton tri sferat strategjike, sipas qëllimit të tyre strategjik, si dhe aktivitetet, institucionet përgjegjëse, indikatorët dhe kornizën kohore ku pritet të realizohen.

#### **Synimi i përgjithshëm i Strategjisë pesëvjeçare për buxhetim gjinor të përgjegjshëm**

Krijimi i politikave gjinore të përgjegjshme, që janë fokusuar në reduktimin e pabarazisë dhe në promovimin e mundësive të barabarta, në përputhje me nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, përmes një procesi të koordinuar dhe transparent për buxhetim gjinor të përgjegjshëm.

### 3.1. Sferat strategjike, synimet strategjike, aktivitetet, institucionet përgjegjëse, indikatorët dhe korniza kohore

<p><b>Sfera strategjike 1</b>  <b>Aplikimi i perspektivës gjinore në programet e buxhetet e ministrive përkatëse, NJVL dhe Qytetit të Shkupit</b></p>			
<p><b>Synimi strategjik 1</b>  <b>Aplikimi i sistemit për integrimin e parimit të barazisë gjinore në programet dhe politikat përmes zbatimit të analizës buxhetore nga aspekti gjinor</b></p>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Institucionet përgjegjëse</b>	<b>Indikatorët</b>	<b>Korniza kohore</b>
Përpilimi i një metodologjie të unifikuar për analizë buxhetore gjinore dhe promovimi i saj	MPPS (në konsultim me ministrinë përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodologji e përpiluar për analizë buxhetore gjinore, me kriteret e përfshira dhe hapat e përcaktuar për zgjedhjen e programeve dhe zbatimi i analizave</li> <li>- Metodologji e pranuar dhe e harmonizuar nga ministrinë përkatëse, NJVL dhe Qyteti i Shkupit</li> <li>- Material i përgatitur për promovimin e metodologjisë</li> <li>- Numri i tribunave të mbajtura për promovim</li> </ul>	Viti 2012
Përgatitja e doracakut me udhëzime për	MPPS (në konsultim me ministrinë)	- Udhëzim i përpiluar me shkrim (doracak)	Viti 2012

<p>zbatimin e Metodologjisë për analizë buxhetore në bazë të gjinisë</p>	<p>përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit)</p>	<p>për zbatimin e metodologjisë për analizë buxhetore gjinore - Kriteret e përcaktuar për: 1) zgjedhjen e programeve ose analizë buxhetore gjinore; dhe 2) personat përgjegjës për zbatimin e analizës buxhetore gjinore. - Doracak i distribuuar, i cili shfrytëzohet nga nëpunësit shtetërorë të ngarkuar me analizat lidhur me buxhetimin gjinor të përgjegjshëm në ministritë përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit</p>	
<p>Zbatimi i analizës buxhetore gjinore, formulimi i rekomandimeve dhe treguesve ose aplikimin e mundshëm në programet e ministrive përkatëse, NJVL dhe Qytetit të Shkupit nga aspekti gjinor</p>	<p>MPPS Ministritë përkatëse NJVL dhe Qyteti i Shkupit</p>	<p>- Së paku një program për çdo shfrytëzues buxhetor është analizuar, në vitin e parë të implementimit - Tregues të formuluar të ndarë sipas gjinisë - Rekomandimet e përpiluara që janë përfshirë në zhvillimin e programeve dhe politikave të mëtejshme - Rekomandimet e propozuara janë inkorporuar në politikat dhe</p>	<p>Periodha kohore 2013-2017</p>

		programet	
Përpilimi i raportit vjetor për analizat e kryera buxhetore nga aspekti gjinor në programet e ministrive përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit dhe distribuimin e të njëjtit me materialin për përgatitjen e buxhetit për vitin e ardhshëm i materialit të njëjtë	MPPS Ministritë përkatëse NJVL dhe Qyteti i Shkupit	- Raport vjetor i përpiluar për analizat gjinore buxhetore të kryera të programeve në ministrinë përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit - Raport i publikuar në ueb faqen e MPPS-së - Distribuimi i raportit në ministrinë përkatëse, NJVL dhe Qytetin e Shkupit, KMB pranë Kuvendit të RM-së	Periodha kohore 2013-2017
Aktivitete promovuese për analizat e kryera buxhetore nga aspekti gjinor në programet e ministrive përkatëse, NJVL dhe Qytetit të Shkupit	MPPS KMB në Parlamentin e RM-së	- Numri i diskutimeve publike për analizë buxhetore gjinore në periudhën e diskutimit të buxhetit në nivel kombëtar dhe lokal	Periodha kohore 2014-2017
Monitorimi i implementimit të rekomandimeve nga analiza buxhetore gjinore në bazë të treguesve të përcaktuar	MPPS dhe Trupi koordinues kombëtar	- Sistem i vendosur për monitorim dhe evaluim - Numri i shfrytëzuesve buxhetorë që i përfshijnë rekomandimet në programet e tyre	Periodha kohore 2014-2017

<b>Sfera strategjike 2</b>			
<b>Avancimi i kornizës ligjore për përfshirjen e BPGJ</b>			
<b>Synimi strategjik 1</b>			
<b>Integrimi i perspektivës gjinore në proceset e planifikimit strategjik dhe buxhetimit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Institucionet përgjegjëse</b>	<b>Indikatorët</b>	<b>Korniza kohore</b>
Përgatitja dhe dorëzimi i informacionit të Qeverisë së R. së Maqedonisë, me analizë rreth situatës me përfundime dhe rekomandime	MPPS	- Informacion i dorëzuar dhe i miratuar	2012
Përmirësimi i bazës ligjore për implementimin e BPGJ	MPPS, MF, Sekretariati i legjislacionit, Ministria e drejtësisë, KMB pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë	- Rregullore e Q. së RM-së për përfshirjen e BGJP në proceset e buxhetimit dhe planifikimit strategjik	2013
Plotësimi i qarkores buxhetore me synime për matjen e efektivitetit të programeve buxhetore dhe qeveritare për nevojat e burrave dhe grave	MF, MPPS, ODU	- Synimet e plotësuara për përgatitjen e propozim-përlloraritjeve buxhetore - Numri i shfrytëzuesve buxhetorë të cilët i implementojnë synimet nga Qarkorja buxhetore	2013  në vit
Plotësimi i Udhëzimit për përgatitjen e planit strategjik	SP, MPPS, format organizuese për planifikim strategjik në ODU	- Perspektiva gjinore e integruar në Udhëzimet për përgatitjen e planit strategjik - Numri i ODU, programet e të cilave në planin strategjik janë të ndjeshëm sa i përket gjinisë	2013  në vit

**Sfera strategjike III**

**Përforcimi i mekanizmave institucionalë dhe ndërtimi i kapaciteteve të palëve të interesuara për integrimin e çështjeve buxhetore në proceset dhe politikat buxhetore**

**Synimi strategjik 1**

**Qasje e koordinuar e institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal rreth çështjeve të BPGJ**

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Indikatorët	Korniza kohore
Dorëzimi i informacionit Qeverisë së R. së Maqedonisë për gjendjen lidhur me BPGJ, me përfundim për themelimin e Trupit kombëtar	MPPS	Informacion i përpiluar dhe i dorëzuar në Qeverinë e R. së Maqedonisë	Jo më vonë se mars 2013
Hartimi dhe delegimi i përfaqësuesve nga institucionet dhe organizatat qytetare në organizatat e trupit kombëtar	MPPS, organet e administratës shtetërore, KMB pranë Kuvendit të R. së Maqedonisë dhe sektori civil	Është kryer lista e pjesëmarrësve	Dhjetor 2012
Formimi i Trupit kombëtar për koordinim dhe monitorimin e implementimit të Strategjisë për BPGJ	Qeveria e R. së Maqedonisë	Është formuar trupi kombëtar	Jo më vonë se mars 2013
Monitorimi dhe analiza e implementimit të Ligjit për mundësi të	MPPS, organet e administratës shtetërore, KMB pranë Kuvendit të R.	Përpilimi i raporteve dhe informacioneve	Në kontinuitet



barabarta nga aspekti i BPGJ-së	së Maqedonisë dhe sektori civil		
<b>Synimi strategjik 2</b>			
<b>Senzibilizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve relevante apo subjekteve të përgjegjshme për përfshirjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor gjatë krijimit të politikave</b>			
Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Indikatorët	Korniza kohore
Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve për përkrahjen dhe zbatimin e analizës buxhetore gjinore	MPPS, ministrinë përgjegjëse, KMB pranë Kuvendit të R. së Maqedonisë, NJVL dhe Qyteti i Shkupit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nëpunësit shtetërorë të identifikuar për zbatimin e analizave BPGJ</li> <li>- Kapacitetet e vlerësuara të institucioneve shtetërore që kanë në ngarkim zbatimin e BPGJ</li> <li>- Grup i formuar për përkrahjen e institucioneve në zbatimin e analizës buxhetore gjinore</li> <li>- Numri i nëpunësve shtetërorë të trajnuar</li> <li>- Numri i deputetëve</li> <li>- Numri i trajnimeve të realizuara</li> <li>- Punonjës i punësuar përgjegjës për BPGJ në SMB</li> <li>- Zhvillimi i moduleve për trajnime të nëpunësve shtetërorë për zbatimin e analizave buxhetore gjinore</li> </ul>	Periudha 2012-2013
Identifikimi i një ekipi të trajnuesve për ndërtimin e kapaciteteve të	MPPS	- Ekip i formuar	2013

institucioneve të përfshira për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e planifikimit strategjik dhe buxhetimit			
Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve të përfshira për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e planifikimit strategjik dhe buxhetimit	MPPS, OASH	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i kapaciteteve</li> <li>- Module të zhvilluara</li> <li>- Doracak i përpiluar për trajnim</li> <li>- Numri i nëpunësve shtetërorë të trajnuar</li> </ul>	në vit
Identifikimi i një ekipi të trajnuesve për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të përfshirë për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e planifikimit strategjik dhe buxhetimit	MPPS	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekip i formuar</li> </ul>	2013
Realizimi i trajnimeve themelore dhe speciale për punonjësit në institucionet shtetërore dhe publike, me fokus të SP dhe sektorët e SP për përfshirjen e BPGJ gjatë krijimit të politikave	MPPS, OASH	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Model i zhvilluar për trajnim</li> <li>- Trajnime të porositura të SP dhe Sektorëve për SP</li> <li>- Kapacitete të përforcuara të SP dhe Sektorëve për SP</li> <li>- Numri i nëpunësve shtetërore që e kanë ndjekur trajnimin</li> </ul>	2013-2017

Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira	MPPS, OASH, NJVL, KMB pranë Kuvendit të R. së Maqedonisë	- Numri i ngjarjeve të realizuara në nivel ndërkombëtar (konferenca, debate, panele), vizita studimore  - Organizimi i së paku dy ngjarjeve për shkëmbimin e praktikave të mira lidhur me BPGJ	2013-2017
Organizimi i aktiviteteve promovuese (konferenca, debate, diskutime publike dhe ngjarje tjera)	MPPS, OASH, NJVL, KMB pranë Kuvendit të R. së Maqedonisë	Numri i ngjarjeve të organizuara në nivel kombëtar dhe lokal	2013-2017

#### 4. Mekanizmat për zbatim, vëzhgim dhe vlerësim

Strategjia për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor ka karakter afatmesëm. Në periudhën vjetore 2012-2017 është planifikuar që të realizohet synimet strategjike dhe aktivitetet e parapara. Por, duhet pasur parasysh që „në fund të fundit përfshirja e barazisë gjinore në ngjarjet kryesore, në politikat dhe praktikat më shumë është proces sesa synim“.<sup>7</sup>

Strategjia për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në momentin e dhënë paraqet një segment nga synimet e përgjithshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për përfshirjen e perspektivës gjinore në ngjarjet kryesore. Prandaj, kjo Strategji

<sup>7</sup> Cituar sipas: „Integrimi gjinor në vendet në zhvillim – studim kririk“. *Fanela Porter, Karolajn Svitmen, Akademski pečat, Shkup, 2009, fq. 26*

është e natyrës së njëhershme, duke pasur parasysh faktin që e njëjta do të inkorporohet, respektivisht do të përfshihet dhe do të bëhet pjesë integrale e Strategjisë kombëtare për barazi gjinore, me miratimin e saj deri në fund të vitit 2012.

Zbatimi i Strategjisë do të metalizohet në planet operative të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore (SKBGJ) në nivel vjetor, me përjashtim të vitit 2012, kur për të njëjtën do të miratohet Plan operativ i posaçëm, i përkrahur nga projekti aktual.

Buxheti për realizimin e aktiviteteve dhe synimeve strategjike do të përgatitet në nivel vjetor në kuadër të SKBGJ, në pajtim dhe koordinim me proceset aktuale të planifikimit strategjik dhe me planifikimin buxhetor të të gjitha subjekteve përgjegjëse për implementimin e Strategjisë.

Me rëndësi të madhe për plotësimin e planeve strategjike dhe aktiviteteve të planifikuara do të jetë edhe përkrahja nga donatorët bilateral dhe multiraletal.

Mbikëqyrje lidhur me zbatimin e dispozitave të Strategjisë do të kryejë MPPS. Për dispozitat e LMB Qeveria do të formojë grup konsultativ ndër-sektorial dhe grup këshillëdhënës për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, që do të përbëhet nga funksionarë/udhëheqës nëpunës shtetëror, përfaqësues nga organizatat qytetare, shoqata të punëdhënësve, ekspertë, përfaqësues nga vetëqeverisja lokale, sindikatat dhe subjektet tjera. Si nëngrup i këtij grup ndër-sektorial, do të formohet nëngrupi për monitorimin e implementimit të Strategjisë, që do të jetë përgjegjës për implementimin e saj në tërësi dhe në kohën e duhur.

## Shtojca 1: Bibliografia

### Rregullativa ligjore dhe tjetër

- Harta për barazi gjinore 2006-2010 - A Roadmap for equality between women and men 2006-2010 {SEC(2006) 275}
- Resolution of the European Parliament on gender budgeting: building public budgets from a gender perspective (2002/2198(INI),  
<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P5-TA-2003-0323+0+DOC+XML+V0//EN>;
- Opinion of the Advisory Committee on Equal Opportunities for Women and Men on gender budgeting,  
[http://www.lex.unict.it/eurolabor/documentazione/altri/doc/po/opinion\\_may03.pdf](http://www.lex.unict.it/eurolabor/documentazione/altri/doc/po/opinion_may03.pdf);
- Strategy for Equality between Women and Men 2010-2015, Brussels, 21.9.2010, COM(2010) 491 final  
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0491:FIN:EN:PDF>
- Final declaration of the High-Level International Conference “Strengthening economic and financial governance through gender responsive budgeting” under the Belgian EU Presidency in 2001 to implement gender budgeting in all countries by the year 2015:  
  
[http://www.gender-budgets.org/uploads/user-S/gender\\_report\\_conf\\_oct01.pdf](http://www.gender-budgets.org/uploads/user-S/gender_report_conf_oct01.pdf)
- The European Charta for equality of women and men in local life by the Council of European municipalities and regions and its neighbours (CCRE/CEMR)

[http://www.ccre.org/docs/banner\\_charter\\_en.doc](http://www.ccre.org/docs/banner_charter_en.doc)

- Conclusions of the German EU Presidency of the European conference “Let’s share the benefit – with gender budgeting towards social justice and equal opportunities”
- Gender budgeting. Final report of the Group of specialists. on gender budgeting Strasbourg, 2005,  
[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/EG-S-GB\(2004\)RAPFIN\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/EG-S-GB(2004)RAPFIN_en.pdf)
- Handbook: Gender Budgeting – practical implementation

[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/CDEG\(2008\)15\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/CDEG(2008)15_en.pdf)

- Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (Gazeta Zyrtare nr. 6/12)
- Ligji për buxhete (Gazeta Zyrtare nr. 64/05, 4/08, 103/08, 156/09 dhe 95/10)
- Plani kombëtar për aksion për barazi gjinore 2007-2012
- Qarkorja buxhetore – [www.finance.gov.mk](http://www.finance.gov.mk)
- Objektivat për përpilimin e propozim përlllogaritjes buxhetore për vitin 2012 - [www.finance.gov.mk](http://www.finance.gov.mk)
- Metodologjia për planifikim strategjik dhe përgatitjen e Programit vjetor për punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare nr. 124/08)
- Doracak për planifikim strategjik, Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2007

## Literatura e shfrytëzuar

- Gender Budgets Make More Cents Country Studies and Good Practice, Debbie Budlender and Guy Hewitt, <http://www.gender-budgets.org/content/view/154/153/>
- Budgeting for equity: Gender budget initiatives within a framework of performance oriented budgeting, Rhonda Sharp, [http://www.gender-budgets.org/component/option,com\\_docman/task,doc\\_view/gid,70/](http://www.gender-budgets.org/component/option,com_docman/task,doc_view/gid,70/)
- “Budgeting for Women’s Rights, Monitoring Government Budgets for Compliance with CEDAW: A Summary Guide for Policy Makers, Gender Equality and Human Rights Advocates”, UNIFEM 2008, based on Diane Elson’s publication “Budgeting for Women’s Rights: Monitoring Government Budgets for Compliance with CEDAW” <http://www.gender-budgets.org/content/view/650/153/>
- Engendering Budgets A Practitioners Guide to Understanding and Implementing Gender-Responsive Budgets, Debbie Budlender and Guy Hewitt, <http://www.gender-budgets.org/content/view/165/153/>
- Gender Mainstreaming Manual, A book of practical methods from the Swedish Gender Mainstreaming Support Committee (JämStöd), Ann Boman Committee Chair, /Ulrika Eklund, Carina Löfgren, <http://www.regeringen.se/content/1/c6/08/19/82/3532cd34.pdf>
- How to do a gender-sensitive budget analysis: contemporary research and analysis, Debbie Budlender, Rhonda Sharp and Kerri Allen <http://www.llbc.leg.bc.ca/Public/PubDocs/docs/360141/AusAIDTr.pdf>
- Gender impact evaluation report from the draft budget

for the Authonomous Region of Andalusia for 2008, Budget Gender Impact Commission, Junta de Anadalusia

- The open budget survey 2010, International Budget Partnership, <http://internationalbudget.org/what-we-do/open-budget-survey/>
- The integration of Gender Budgeting in Performance-Based Budgeting, Dr. Elisabeth Klatzer, Watch Group. Gender and Public Finance, Conference for Public Budgeting Responsible To Gender Equality, Presupuestación Pública Responsable con la Igualdad de G, June 9-10, 2008, Bilbao
- Linking what's new – Gender Budgeting and Participation for Gender Equality, Dr. Elisabeth Stiefel, European Gender Budgeting Network, Conference for Public Budgeting Responsible To Gender Equality, Presupuestación Pública Responsable con la Igualdad de G, June 9-10, 2008, Bilbao
- Gender Budgeting in the European Union, Sara Hector, The Evaluation Unit, Directorate General for Budget, Conference for Public Budgeting Responsible To Gender Equality, Presupuestación Pública Responsable con la Igualdad de G, June 9-10, 2008, Bilbao
- Analiza dhe vlerësimi i procesit buxhetor dhe reformat në politikat buxhetore, nga aspekti i barazisë gjinore. Aleksandra Simjanovska, 2012, Shkup
- Analiza buxhetore-gjinore e mbrojtjes sociale dhe politikat aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë, Ministria e punës dhe politikës sociale – RM, 2010, <http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Rodova%20Analiza%20Makedonski%2023%2002%202010.pdf>



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

305:[336.12:354(497.7)]2012/17"

STRATEGJIA për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Republikën e Maqedonisë :  
2012-2017. - Shkup : Ministria e punës dhe politikës sociale, 2013. - 49 стр. : табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 45-46. - Содржи и: Shtojca 1-2

ISBN 978-608-4595-25-0

а) Родово одговорно буџетирање - Стратегија - Македонија - 2012-2017

COBISS.MK-ID 93782282



REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE